

# Relacion teknik

Objekti: **SISTEMIM ASFALTIM I RRUGES NE  
FSHATIN ALLKAJ**

## **1) ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE**

### **a) HYRJE**

Ne kuadrin e zhvillimeve ekonomiko-shoqerore dhe kerkesave urbane te qytetit te Lushnjes nevoja per permiresimin e rrjetit rrugor eshte nje kerkesa urgjente. Rruga ne fshatin Allkaj ,kete urgjence e ben me te dukshme jo **vetem** per gjendjen e saj te mjeruar ndertimore dhe vizuale por edhe sepse eshte rruge kryesore e ketij fshati.

### **2)OBJEKTI I RELACIONIT**

Mbeshtetur ne detyren e projektimit dhe kerkesat e Bashkise Lushnje objekti i ketij relacioni teknik eshte paraqitja e projekt zbatimit ku prezantohen masat dhe zgjidhjet e nevojshme planifikuse,arkitektonike dhe inxhinierike qe jane parashikuar ne projekt per elemente te ndryshem te tij, zgjidhje urbane, problemet arkitektonike dhe inxhinierike si : shtresat e rruges ,disiplinimi i ujrave, rrjeti inxhinierik, etj.

Bazuar ne azhornimin ne terren,shqyrtimin e dokumentave perkatese u realizua projekt zbatimi.

## **3)ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE**

### **a) Analiza urbane**

Nga pikëpamja urbane, rruga qe perfshin projekti ndodhet në fshatin “ Allkaj “Lushnje . Eshte rruga kryesore e fshatit e cila realizon lidhjen jo vetem brenda fshatit por edhe me zonen perreth, si me siperfaqet e tokave bujqesore edhe me qendrat e tjera te banuara.



### **Analiza arkitektonike**

Ne aspektin arkitektonik sic e permendem dhe me larte rruga eshte ne gjendje te mjerueshme natyrale ne te gjithë elementet perberes se sajë. Ato jane prej materiale prej guri dhe granili te hedhur vazhdimisht per mbulimin e gropave nga demtimet pa asnje kerkese arkitektonike, si forma ngjyra dhe funksionale. Terreni eshte kodrinor dhe perqindja e pjerrtise eshte e ndryshme ajo varion nga 1%-10% dhe trasea e rruges eshte me gërmim dhe mbushje. Gjatesia e pergjithshme eshte 750 ml dhe me gjerësi 3.5-4 ml. Ndricimi mungon dhe ka nevojë per nderhyrje urgjente. Sinjalistika mungon jo vetem per rrugen e gjendjes ekzistuese por duhet evidentuar qe zgjidhja e re urbane do te kerkoje sinjalistike te pershtateshme per funksionin qe do te mare kjo rruge. Arkitektura e objekteve per rreth dhe gjate rruges jane ndertesa private 1-3kt .

### **b) Analiza inxhinierike**

Kanalizimet e ujërave të bardha (K.U.B) rrjedhin pergjate kanaleve te hapur anesore te cilet vende vende jane mbyllur.

Mungojne shtresat rrugore dhe rruga eshte mjaft e demtuar, ajo eshte ne gjendje natyrale pa shtresa asfalti dhe jashte kushteve teknike.

### **Konkluzione**

Mbeshtetur ne problematiken e gjendjes ekzistuese dhe nga kerkesa e shtruarë nga Bashkia Lushnje konform planit te zhvillimit te qytetit dhe rivleresimit qe kerkon hapësira ku do te ndertohet kjo rruge, u studiuë dhe u paraqiten ne kete projekt e gjithë problematika e zones e cila do te trajtohet ne faza te ndryshme.

## **4) PËRSHKRIMI I PROJEKTIT**

### **a) ZGJIDHJA E PLANIFIKIMIT URBAN KONSISTON NE:**

- Ruajtjen e gjurmës ekzistuese të rrugës.
- Përmirësimin e treguesve teknik, në planimetri dhe në altimetri.

### **b) PLANIMETRIA E RRUGES**

Në kontekstin e zhvillimit planimetrik dhe në zbatim të detyrës së projektimit për rikonstruksionin e rrugës, duke respektuar karakteristikat gjeometrike ekzistuese, konsulenti ka përmirësuar parametrat gjeometrik dhe teknik brenda mundësive që ofrojnë kushtet territoriale. Gjatë germimit për formimin e kasonetes së rrugës materialet mbushëse të rrugës do të germohen me kujdes pa u perziere me dherat, pasi do të riperdoren për mbushje në disa pjesë të rrugës për nivelimin e kasonetes para hedhjes së shtresave të cakullit dhe të stabilizantit.

Fondi rezerve përfshin punimet të cilat do të dalin gjatë punimeve të dellit mbi të cilin kalon dhe rruga. Në planimetrinë e projekt zbatimit të objektit bashkëngjitur këtij relacioni janë materializuar këto përmirësime:

- Profili gjatësor i rrugës është përmirësuar për të shmangur shkallezimet
- Profili terthorë të dhëna në projekt 1 tip, e cila është zgjidhur në përputhje me kushtet e relievit të zonës dhe mundësisë për të realizuar seksionin e rrugës.
- Mbi trupin e rrugës pasi të bëhet nivelimi me grejder parashikohet mbushja e gropave me material të germuar i cili të përhapet dhe ngjeshet me makineri. Në vijim do të bëhet karikimi me shtresat përkatëse cakell 10cm, stabilizant t=5cm, binder 6 cm dhe asfalti 4 cm.

### **c). Rrjete inxhinierike**

#### **- K.U.B**

Drenazhimi i ujërave sipërfaqësore është parashikuar të realizohet nëpërmjet pjerresive terthore të rrugës duke i mbledhur ujrën në kanalet sipërfaqësore në anë të rrugës të cilat do të jenë prej betoni me një trashësi 10cm, e cila vendoset mbi një shtresë zhavorri prej 15 cm. Në vendet ku kanali ndërpritet nga rruget terthore është vendosur tombino me tub të brinjëzuar me diametër 500mm. Kuota e formimit të germimit duhet të përdoret si bazë për shtresën e poshtme të tombinove, e cila duhet të përgatitet në përputhje me kërkesat e projektit. Kjo shtresë duhet të jetë e rrafshët dhe me pjerrësinë e duhur, të cilat do të mundësonin ndërtimin e duhur të tombinos dhe siguronin rrjedhjen e lirshme të ujit nëpër tombino. Të gjitha fugat e tubave të betonit duhet të mbushen me llaç çimento. Në të dyja anët e tombinos do të vendosen pjesët e betonit të përcaktuara si në projekt.

### **-Rrjeti elektrik**

Per shkak se ne terren mungon sistemi i ndricimit eshte menduar venia e 20 shtyllave elektrike te ndricimit me krah me nje lartesi 7m dhe qe do te vendosen cdo 25 m nga njera tjetra. Prane shtylles se ndricimit do te jete dhe puseta e kontrolli 40x40x40. Lidhja midis tyre do te behet me tuba plastike 100 si eshte e paraqitur dhe ne projekt. Zeri i analizes se ndricuesve perfshin objektin e perfunduar me te gjitha punimet e nevojshme.

### **Konkluzione.**

Mbeshtetur ne detyren e projektimit dhe duke mare ne konsiderate sygjerimet e bera nga drejtoria e planifikimit u studiuua dhe u paraqiten ne kete projekt zbatim, profili gjatesor, seksioni terthore tip, si dhe perspektiven e zhvillimit urban. Bashkelidhur ketij relacioni jepet projekti per permiresimin e nenshtresave ekzistuese dhe zevendesimin e shtresave te trupit te rrugeve , drenimin e ujrave dhe materialin grafik te paraqitur me poshte:

- Planimetria e projekt-zbatimit gjurma se bashku me KUB
- Profila gjatesore
- Prerje terthore tip
- Detaje te projektit
- Relacion teknik
- Specifikime teknike preventiv

**Ark. MAKSIM ÇUKO**

**Ark. Enis Manoku**